



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.01.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me emërimin gjyqtarë të diplomuarve për magistratë në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018-2019, si më poshtë:

1. “Për emërimin gjyqtar të znj. Erlanda Agaj”;
2. “Për emërimin gjyqtar të z. Marko Boshku”;
3. “Për emërimin gjyqtar të znj. Elisabeta Gjoni”;
4. “Për emërimin gjyqtar të z. Klejda Çapja”;
5. “Për emërimin gjyqtar të z. Artur Prenga”;
6. “Për emërimin gjyqtar të z. Mirjan Mustafaj”;
7. “Për emërimin gjyqtar të znj. Kostandina Kuro”;
8. “Për emërimin gjyqtar të znj. Iva Zemani”;
9. “Për emërimin gjyqtar të znj. Enisa Shahini”;
10. “Për emërimin gjyqtar të znj. Ema Shaholli”;
11. “Për emërimin gjyqtar të z. Shkëlzen Liçaj”;
12. “Për emërimin gjyqtar të z. Xhevdet Lika”;
13. “Për emërimin gjyqtar të z. Ligoraq Toshi”;
14. “Për emërimin gjyqtar të z. Hazbi Balliu” ;
15. “Për emërimin gjyqtar të z. Florin Demollari”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:06 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 10. Erjon Muharremaj (anëtar)*
- 11. Marçela Shehu (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

9. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

10. Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njësisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

11. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

12. Gregor Borkowski, EURALIUS.

13. Erion Fejzulla, USAID.

14. Valbona Bala, USAID.

15. Aida Mako, EURALIUS.

16. Anisa Kuqi, EURALIUS.

17. Arlind Maloku, QE.

18. Përfaqësues të medias. (Kameramanët prezent vetëm në prezantimin e rendit të ditës).

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me emërimin gjyqtarë të diplomuarve për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018-2019, si më poshtë:

1. “Për emërimin gjyqtar të znj. Erlanda Agaj”;
2. “Për emërimin gjyqtar të z. Marko Boshku”;
3. “Për emërimin gjyqtar të znj. Elisabeta Gjoni”;
4. “Për emërimin gjyqtar të z. Klejda Çapja”;
5. “Për emërimin gjyqtar të z. Artur Prenga”;
6. “Për emërimin gjyqtar të z. Mirjan Mustafaj”;
7. “Për emërimin gjyqtar të znj. Kostandina Kuro”;
8. “Për emërimin gjyqtar të znj. Iva Zemani”;
9. “Për emërimin gjyqtar të znj. Enisa Shahini”;
10. “Për emërimin gjyqtar të znj. Ema Shaholli”;
11. “Për emërimin gjyqtar të z. Shkëlzen Liçaj”;
12. “Për emërimin gjyqtar të z. Xhevdet Lika”;
13. “Për emërimin gjyqtar të z. Ligoraq Toshi”;

14. “Për emërimin gjyqtar të z. Hazbi Balliu” ;
15. “Për emërimin gjyqtar të z. Florin Demollari”.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Siç jeni vënë në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor po fillon mbledhjen e parë për vitin 2020, mbledhjen e datës 9 janar.

Janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe siç jeni vënë në dijeni nga rendi i ditës, sot për shqyrtim do merren nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor 4 çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve lidhur me emërimin e gjyqtarëve të diplomuar për magistratë nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018-2019. Janë gjithsej 15 magistratë të cilët i janë nënshtruar një verifikimi të thelluar të figurës dhe pasurisë dhe është hera e dytë që Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të këtij verifikimi, emëron magistratët që kanë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës. Vendimmarrja e sotshme i paraprin në fakt caktimit të tyre në pozicione që do bëhet në ditët e ardhshme nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në ato gjykata të rretheve gjyqësore, për të cilat nevoja është më e madhe, si nga ana organike ashtu edhe nga numri i çështjeve gjyqësore që presin për t’u shqyrtuar. Ky është projekt-akti i parë.

Projekt-akti i dytë ka të bëjë me kërkesën e gjyqtarit {...} për pagimin e pagës si gjyqtar gjatë periudhës së pezullimit si dhe për deklarin e mbarimit të statusit të magistratit.

Projekt-akti tjetër ka të bëjë me deklarin e mbarimit të statusit të magistratit, për gjyqtaren Marina Rraboshta, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit.

Dhe projekt-akti i fundit është shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e mbarimit të statusit të magistratit, për gjyqtarin {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Përpara se të kalojmë në relatimin e akteve nga relatorët përkatës, unë i ftoj kamerat të largohen nga ambientet e Këshillit, duke ftuar gazetarët për t’u ulur pranë ambientit për të vazhduar diskutimet.

(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, vazhdojmë me relatimin e projekt-aktit të parë, që ka të bëjë me emërimin gjyqtar të zonjës Erlinda Agaj, relator i të cilës është zoti Alban Toro.

Ia jap fjalën zotit Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, për këtë shkak është përgatitur edhe relacioni përkatës, i cili është bazuar në dispozitat ligjore përkatësisht nenet 136/a, 147/a, pika 1, shkronja “a”, e Kushtetutës, nenin 35 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 229, datë 24.10.2019 “Për kualifikimin e kandidates znj. Erlinda Agaj (*lapsus emri, duhet Erlinda Agaj*) dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtare”.

Pasi është kryer procedura përkatëse e verifikimit konform vendimit të Këshillit nr. 75, 23.05.2019 dhe është konstatuar që zonja Erlinda Agaj (*lapsus emri, duhet Erlinda Agaj*) plotësonte kushtet dhe kriteret ligjore për rekrutimin e saj si gjyqtare, miratoi vendimin 229, datë 24.10.2019 me të cilën u konkludua se për këtë kandidate nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërimin si gjyqtare.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni ka hartuar edhe projektvendimin “Për emërimin gjyqtare të znj. Erlinda Agaj (*lapsus emri, duhet Erlinda Agaj*)”, si një hap të mëtejshëm, në kuadër të emërimit të saj si gjyqtare dhe në bazë të këtij vendimi (projekti) kandidatja Erlinda Agaj (*lapsus emri, duhet Erlinda Agaj*) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet “gjyqtare”, ndërsa ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas pikës 2 të projektvendimit parashikohet se një kopje e këtij vendimi duhet t’i njoftohet gjyqtarës së emëruar.

Së fundi, vendimi përcakton momentin e hyrjes në fuqi të tij, që është pikërisht në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit.

Për këtë shkak është përgatitur edhe projektvendimi përkatës, dispozitivi i të cilës

përcakton se: Të emërojë gjyqtare znj. Erlanda Agaj. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim paraprak?

Kalojmë në votim të projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtare znj. Erlanda Agaj. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në relatimin e projekt-aktit të dytë, për të cilin relator është sërish zoti Alban Toro, për emërimin gjyqtar të zotit Marko Boshku.

Alban Toro: Po! Faleminderit!

Edhe për këtë relacion është përdorur e njëjta bazë ligjore, kështu që nuk po humbas kohë duke cituar dispozitat ligjore përkatëse.

Po konform vendimit të Këshillit nr. 75, 23.05.2019 edhe për këtë kandidat është kryer verifikimi përkatës për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e tij si gjyqtar.

Në këtë kuadër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka procedurën e vendimit nr. 230, datë 24.10.2019 me të cilën u konkludua se kandidati Marko Boshku nuk ka të dhëna që mund

të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtar, duke u vendosur më tej kualifikimi i tij dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të këtij stadi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të z. Marko Boshku”, sipas të cilit, kandidati Marko Boshku, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet “gjyqtar”, ndërsa ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas pikës 2 të projektvendimit parashikohet se një kopje e tij i njoftohet gjyqtarit të emëruar.

Së fundi, vendimi përcakton momentin e hyrjes në fuqi, që është pikërisht në datën e publikimit në faqen zyrtare.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi përkatës i propozuar në dispozitivin e të cilit propozohet: Të emërojë gjyqtar z. Marko Boshku. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit nëse s’kemi diskutime?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar z. Marko Boshku. Një kopje e këtij

vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që është “Emërimin gjyqtar të znj. Elisabeta Gjoni”. Edhe për këtë është relator zoti Alban Toro.

Alban Toro: Edhe dispozitat ligjore në këtë relacion janë të njëjta me kandidatët paraardhës.

Këshilli, pasi përfundoi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidates Elisabeta Gjoni konform vendimit të Këshillit 75, 23.05.2019, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, miratoi vendimin nr. 231, datë 24.10.2019, me të cilin u konkludua se për kandidaten Elisabeta Gjoni nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtare, dhe vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të znj. Elisabeta Gjoni”, sipas të cilit, kandidatja Elisabeta Gjoni, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet “gjyqtare”, ndërsa ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës së emëruar.

Dhe vendimi përcakton edhe momentin e hyrjes në fuqi, që korrespondon me datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë kuadër është përgatitur edhe projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit është parashikuar se: Të emërojë gjyqtare znj. Elisabeta Gjoni. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar nga zoti Toro?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtare znj. Elisabeta Gjoni. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatës. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me “Emërimin gjyqtar të zonjës Klejda Çapja”, për të cilën relator është sërish zoti Alban Toro.

Alban Toro: E njëjta bazë ligjore shoqëron edhe këtë relacion.

Këshilli, në vijim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatës Klejda Çapja, me vendimin 232, datë 24.10.2019 ka konkluduar se për kandidaten e sipërcituar nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërimin si gjyqtare dhe u vendos skualifikimi, kualifikimi, - më falni, kualifikimi i saj dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure Komisioni ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtare të znj. Klejda Çapja”, sipas të cilit kandidatja Klejda Çapja, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, të emërohet gjyqtare, ndërsa ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në projektvendim është parashikuar komunikimi i këtij vendimi në pikën 2 të këtij projekti gjyqtarës së emëruar. Dhe së fundi, hyrja në fuqi e tij, që korrespondon me datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është përgatitur projekti përkatës, në dispozitivin e të cilit është përcaktuar: Të

emërojë gjyqtare znj. Klejda Çapja. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatori.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtare znj. Klejda Çapja. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me "Emërimin si gjyqtar të z. Artur Prenga", relatimi i të cilit do bëhet sërish nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: E njëjta bazë ligjore shoqëron edhe këtë relacion.

Në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. Artur Prenga, Këshilli me vendimin 233, datë 24.10.2019 konkludoi se për kandidatit Artur Prenga nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërimin si gjyqtar dhe vendosi më tej kualifikimin i tij si dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni ka hartuar projektvendimin "Për emërimin gjyqtar të zotit Artur Prenga" sipas të cilit, ky i fundit, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtar nëse ai plotëson kushtet

dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar se një kopje e tij i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Dhe së fundi, vendimi përcakton momentin e hyrjes në fuqi të tij që është pikërisht më datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë kuadër është përgatitur edhe projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju propozohet: Të emërojë gjyqtar z. Artur Prenga. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar z. Artur Prenga. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me “Emërimin si gjyqtar të zotit Mirjan Mustafaj”, relator i të cilit do të jetë zonja Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka përfunduar procedurën e verifikimi të kushteve

dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. Mirjan Mustafaj, sipas vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës miratoi vendimin nr. 234, datë 24.10.2019, me të cilin, pasi u konkludua se për kandidatin Mirjan Mustafaj nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtar, u vendos kualifikimi i tij dhe vijimi i procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të z. Mirjan Mustafaj”, sipas të cilit, kandidati Mirjan Mustafaj, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtar, ndërsa ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe nenit 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të emërojë si gjyqtar zotin Mirjan Mustafaj. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kandidatit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar nga relatorja.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar znj. Mirjana Mustafaj, - më fal, zotin Mirjan Mustafaj. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky

vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në shqyrtimin e projekt-aktit tjetër, që ka të bëjë me “Emërimin gjyqtar të zonjës Kostandina Kuro”. Edhe për këtë projekt-akt, relatimi do bëhet nga zonja Shehu.

Marçela Shehu: Po!

Edhe për kandidaten znj. Kostandina Kuro është realizuar dhe ka përfunduar e plotë procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtare të kësaj kandidateje. Me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr. 235, datë 24.10.2019, me të cilin, pasi u konkludua se për kandidaten Kostandina Kuro nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtare, u vendos kualifikimi i saj dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projekt vendimin “Për emërimin gjyqtar të znj. Kuro”, sipas të cilit, kandidatja e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtare, për shkak se ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të emërojë si gjyqtare znj. Kostandina Kuro. Një kopje e vendimit t’i njoftohet gjyqtarës së emëruar.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar nga relatorja?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtare znj. Kostandina Kuro. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me “Emërimin si gjyqtar të zonjës Iva Zemani”. Edhe për këtë projekt-akt relatore është zonja Marçela Shehu. Të lutem!

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Për kandidaten zonjën Iva Zemani, pas përfundimit të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kësaj kandidateje, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr. 236, datë 24.10.2019, me të cilin, pasi është konkluduar se për kandidaten Iva Zemani nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtare, u vendos kualifikimi i saj dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtare të znj. Iva Zemani”, sipas të cilit, kandidatja Iva Zemani, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtare, ndërsa ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe nenit 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të emërojë gjyqtare kandidaten znj. Iva Zemani. Një kopje e vendimit t'i njoftohet gjyqtares pas miratimit nga Këshilli. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar nga relatorja?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtare znj. Iza Zemani. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës që është “Për emërimin gjyqtar të zonjës Enisa Shahini”, relator i të cilit është zoti Ilir Toska. Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, zonja Enisa Shahini është diplomuar për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Për të është bërë verifikimi i kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtare dhe në përfundim Këshilli ka vendosur me vendimin nr. 237, datë 24.10.2019 për kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në këto kushte, Këshilli është para rastit për të vendosur emërimin gjyqtar të zonjës Enisa Shahini. Për këtë është përgatitur edhe projekt-akti përkatës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga zoti Toska.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar znj. Enisa Shahini. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në fakt, do doja që edhe për projekt-aktet që kemi kaluar, pika e fundit e hyrjes në fuqi të projektvendimit të reflektohet ndryshimi që të jetë “projektvendimi të hyjë në fuqi menjëherë dhe publikohet më pas në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me emërimin gjyqtar të zotit Shkëlzen... më fal, të “Emërimit gjyqtar të zotit Shkëlzen Liçaj”, relator i të cilit është zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe zoti Shkëlzen Liçaj është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, në vitin 2019.

Edhe për këtë janë ndjekur procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar dhe në përfundim, Këshilli me vendimin nr. 239, datë 24.10.2019 ka vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Për rrjedhojë, Këshilli është para rastit për të vendosur emërimin si gjyqtar të zotit Shkëlzen Liçaj. Për këtë është përgatitur edhe projekt-akti i emërimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në miratimin e projekt-aktit të propozuar nga relatori.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar z. Shkëlzen Liçaj. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në shqyrtimin e projekt-aktit tjetër, i cili ka të bëjë me “Emërimin e gjyqtarit znj. Ema Shaholli”, relatimi i të cilit do bëhet nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Edhe për kandidaten znj. Ema Shaholli është realizuar procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtare të kësaj kandidateje dhe pas verifikimit, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr. 238, datë 24.10.2019, me të cilin, pasi u konkludua se për kandidaten Ema Shaholli nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtare, u vendos kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtare të znj. Ema Shaholli”, sipas të cilit, kjo kandidate, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtare, për shkak se plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe nenit 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa më sipër, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të emërojë gjyqtare znj. Ema Shaholli. Një kopje e vendimit t'i njoftohet gjyqtarës së emëruar.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin e propozuar.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtare znj. Ema Shaholli. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarës së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projektvendimi i radhës, i cili ka të bëjë me emërimin gjyqtar të zotit Xhevdet Lika, relator i të cilit është zoti Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe zoti Xhevdet Lika është diplomuar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Për të janë bërë verifikimet në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore për rekrutimin si gjyqtar. Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 240, datë 24.10.2019 ka vendosur kualifikimin e zotit Xhevdet Lika dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.

Për rrjedhojë, Këshilli është para rastit për të vendosur emërimin si gjyqtar të zotit Xhevdet Lika. Për këtë është përgatitur edhe projekt-akti përkatës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit të propozuar.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar z. Xhevdet Lika. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me “Emërimin gjyqtar të zotit Ligoraq Toshi”, relatimi i të cilit do të bëhet sërish nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka përfunduar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit zotit Ligoraq Toshi, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ka miratuar vendimin 245, datë 29.10.2019, me të cilin, pasi u konkludua se për kandidatin Ligoraq Toshi nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtar, u vendos kualifikimi i tij dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të z. Toshi”, sipas të cilit, ky kandidat, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtar, ndërsa ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136 të Kushtetutës dhe ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor emërimin si gjyqtar të zotit Ligoraq Toshi. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të emëruar.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, hedhim në votim projekt-aktin e propozuar.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar z. Ligoraq Toshi. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër të radhës, i cili ka të bëjë me emërimin gjyqtar të zotit Hazbi Balliu, relator i të cilit është zoti Alban Toro.

Alban Toro: Po! Faleminderit!

Në vijim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. Hazbi Balliu, Këshilli, me vendimin nr. 254, datë 12.11.2019, ka konkluduar se për kandidatin Hazbi Balliu nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtar dhe ka vendosur kualifikimi i tij dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të z. Hazbi Balliu”, sipas të cilit, kandidati Hazbi Balliu, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtar, ndërsa ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë kuadër, Komisioni ka përgatitur dhe draftin e projektvendimit përkatës, në dispozitivin e të cilit ju propozohet të emërojë gjyqtar zoti Hazbi Balliu. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit të propozuar.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të emërojë gjyqtar z. Hazbi Balliu. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i fundit, i cili ka të bëjë me emërimin gjyqtar të zotit Florin Demollari, projekt-akt i cili do të relatohet nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka përfunduar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. Florin Demollari, sipas Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me Vendimin nr. 253, datë 12.11.2019, ka vendosur: “Skualifikimin e kandidatit z. Florin Demollari, i diplomuar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018 - 2019 dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar”.

Kandidati z. Florin Demollari ka ushtruar të drejtën ligjore të ankimit gjyqësor ndaj vendimit si më lart të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 262, datë 23.12.2019, ka vendosur: “- Pranimin e padisë së paditësit Florin Demollari; Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 253, datë 12.11.2019 “Për skualifikimin e kandidatit z. Florin Demollari”; Kualifikimin për emërim të paditësit Florin Demollari i diplomuar si magjistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 – 2019; Detyrimin e palës së paditur Këshilli i

Lartë Gjyqësor të vijojë procedurën e emërimit si gjyqtar të paditësit Florin Demollari”.

Në këto kushte, pavarësisht ndërmarrjeve ligjore që Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të konsiderojë në të ardhmen në lidhje me vendimin si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit, aktualisht, për sa kohë jemi para një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Këshilli ka detyrimin ligjor për zbatimin e tij. Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të z.Florin Demollari”, sipas të cilit, kandidati Florin Demollari, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, emërohet gjyqtar, për sa kohë, sipas vendimit gjyqësor të zbatueshëm në këtë rast, ndërsa është urdhëruar kualifikimi për emërim dhe detyrimi i Këshillit për të vijuar procedurën e emërimit të z.Demollari, është konsideruar se ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136 të Kushtetutës dhe nenit 35 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të emërojë gjyqtar zotin Florin Demollari. Një kopje e vendimit t’i komunikohet gjyqtarit të emëruar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit.

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të emërojë gjyqtar zotin Florin Demollari. Një kopje e

këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.01.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit {...} për pagimin e pagës si gjyqtar, gjatë periudhës së pezullimit dhe për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:06 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
11. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
12. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
13. *Erion Fejzulla, USAID.*
14. *Valbona Bala, USAID.*
15. *Aida Mako, EURALIUS.*
16. *Anisa Kuqi, EURALIUS.*
17. *Arlind Maloku, QE.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit {...} për pagimin e pagës si gjyqtar, gjatë periudhës së pezullimit dhe për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit.

Naureda Llagami: Atëherë, Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit lidhur me kërkesën e gjyqtarit {...} për pagimin e pagesës si gjyqtar gjatë periudhës së pezullimit dhe për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit.

Siç jeni në dijeni kjo çështje vijon që nga mbledhja plenare e datës 19.12.2019, ku gjyqtari ishte i ftuar për t'u paraqitur dhe dëgjuar përpara Këshillit lidhur me kërkesat e tij.

Për më tepër informacion lidhur me këtë çështje, ia jap fjalën relatores së këtij projekt-akti, znj. Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Relacioni i plotë është lexuar në një nga mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nuk e di nëse Këshilli vlerëson që duhet rilexuar situata lidhur me faktet apo të vijojmë me...

Dakord.

Atëherë, pas relatimit të aktit përkatës, lidhur me kërkesën e paraqitur nga gjyqtari {...} dhe pas dëgjësës që realizoi Këshilli i Lartë Gjyqësor me këtë gjyqtar, gjyqtari {...}, më datë 23.12.2019, përveç kërkesës që ai kishte paraqitur më parë në kohë për rikthimin në detyrë dhe për pagesën, për dhënien e pagave që ai nuk kishte marrë që nga koha e pezullimit, ka paraqitur gjithashtu edhe një kërkesë me të cilën ai kërkon heqjen dorë nga statusi i magjistratit.

Në këtë mënyrë, Komisioni ka çmuar të rivlerësojë qëndrimin e tij lidhur me propozimin konkret para Këshillit të Lartë Gjyqësor. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ashtu siç relatoi edhe në mbledhjen plenare përkatëse, ka konkluduar se shkak për të cilin ishte vendosur pezullimi i këtij gjyqtari me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë tashmë ka rëndë.

Ju rikujtoj që gjyqtari {...} ishte pezulluar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkak të procedimit të tij penal, procedim penal i cili tashmë është i pushuar me vendim penal të formës së prerë.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të revokojë vendimin nr. 47, datë 29.04.2015, të ish-Këshillit të Lartë të

Drejtësisë, “Mbi pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, {...}”. T’i njohë gjyqtarit {...} të drejtën për përfitimin e pagës për të gjithë kohën e pezullimit nga detyra, nga data 29.04.2015, duke mos konsideruar të arsyeshme që të propozojë rikthimin e tij në detyrë për sa kohë ai ka paraqitur gjithashtu përpara Këshillit edhe kërkesën e tij me të cilën kërkon të heqë dorë nga statusi i magjistratit.

Propozimi që lidhet me projektvendimin e parë është pikërisht ky pra revokimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra dhe njohjen e së drejtës për përfitimin e pagës për këtë gjyqtar për të gjithë kohën e pezullimit, pra nga data 29.04.2015.

Pas miratimit të këtij projektvendimi, do të kalojmë më pas edhe në propozimin tjetër që lidhet me kërkesën që ka paraqitur gjyqtari për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimin e ardhur nga relatorja?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të revokojë vendimin nr. 47, datë 29.04.2015, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Mbi pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, {...}”.

T'i njohë gjyqtarit {...} të drejtën për përfitimin e pagës për të gjithë kohën e pezullimit nga detyra, nga data 29.04.2015.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë prapë, i jap fjalën prapë për të relatuar zonjës Marçela Shehu, lidhur me situatën tjetër faktike për rastin e zotit {...}.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Ashtu siç citova edhe pak më përpara, më datë 23.12.2019 gjyqtari {...} ka depozituar kërkesën me anë të së cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit për shkak të mbushjes së moshës 65 vjeç dhe së drejtës për të përfituar pension të parakohshëm pleqërie.

Duke u bazuar në motivimin e paraqitur nga gjyqtari, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e ka trajtuar kërkesën dhe deklarin e zotit {...} sipas pikës 3 të nenit 65 të ligjit 96/2016, i cili shprehet se: “3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Në këto kushte, Komisioni, ka vlerësuar se pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga statusi i magjistratit; kjo kërkesë është e motivuar, pra gjyqtari në fjalë ka parashtruar motiv për dorëheqjen e tij, motiv ky që përveçse personal, nuk mund të vlerësohet si i pajustificuar dhe; së treti, dhënia e efekte të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast duhet të mbahet në vëmendjen e Këshillit, si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtarit z. {...} duhet të japë efektet, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtarit dhe shkakun e paraqitur prej tij nga njëra anë, por edhe faktin se ai ka qenë i pezulluar nga detyra dhe nuk ka nevojë për lënien e një kohe të mjaftueshme brenda të cilës gjyqtari do të marrë masat për dorëzimin e detyrës nga ana e tij.

Nga vlerësimi mbi këto kritere, i propozojmë Këshillit që efektet e këtij urdhërimi të fillojnë më datë 15.01.2020, pra është edhe data në të cilën gjyqtarit i lid e drejta për të kërkuar pension pleqërie.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 15.01.2020. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, nëse s'kemi diskutime lidhur me projekt-aktin e propozuar, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 15.01.2020.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.01.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës {...} për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:06 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
11. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
12. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
13. *Erion Fejzulla, USAID.*
14. *Valbona Bala, USAID.*
15. *Aida Mako, EURALIUS.*
16. *Anisa Kuqi, EURALIUS.*
17. *Arlind Maloku, QE.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës { ... } për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e tretë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të znj. {...} , për shkak të dorëheqjes nga detyra. Projekt-akt i cili do të relatohet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 22.11.2019, është depozituar një kërkesë me shkrim nga gjyqtarja e Gjykatës e Apelit Shkodër, znj. {...} , nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit. Fillesat e saj kjo magjistratë i ka filluar me emërimin si ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Madhësisë së Madhe me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 13, datë 24.11.1993

Me vendimin nr.1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë znj. {...} , ndihmësgjyqtare e Malësisë së Madhe emërohet gjyqtare.

Me dekretin nr.8179, date 17.05.2013 të Presidentit të Republikës znj. {...} , emërohet gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku dhe aktualisht ushtron funksionin e magjistratit.

Në kërkesën e saj gjyqtare {...} ka kërkuar që ndër të tjera: “Mbarimi i mandatit të realizohet edhe përpara afatit të parashikuar nga neni 65/2 të ligjit nr.96/2016..”. Në rastin konkret, dorëheqja e znj. {...} është kërkuar në mbështetje të pikës 3, të nenit 65, të ligjit të Statusit.

Si motiv të dorëheqjes znj. {...} ka parashtruar diagnostikimin me “Discopatia lombare et curriculare” (që do të thotë dëmtim i diskut intervertebrale) dhe në këtë kontekst literatura mjekësore identifikon si një ndër shkaqet e kësaj diagnoze jetën sedentare. Dorëheqja sipas nenit 65 të ligjit të sipërcituar jep efekte në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes, domethënë më datë 31.12.2019.

Për rrjedhojë, znj. {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës 31.12.2019 duke e mbështetur këtë kërkim në diagnozën e sipërcituar.

Sipas nenit 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet

paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Nga informacioni i administruar, në kohën e paraqitjes së kërkesës së përshpejtuar të dorëheqjes nga magjistratja, nga kancelarja e Gjykatës së Apelit Shkodër rezultonte se për 11-mujorin 2019, janar 30 nëntor 2019 ngarkesa për çështje të gjykuara për Gjykatën e Apelit Shkodër është si vijon:

{...} 67 çështje; {...} 239 çështje; {...} 176 çështje; {...} 208 çështje; {...} 251 çështje; {...} 275 çështje; {...} 265 çështje; {...} 225 çështje.

Ndërkohë që për një nga çështjet civile dhe konkretisht me nr. akti 2104, datë 24.12.2014, me paditës {...}, etj., ishin zhvilluar 73 seanca gjyqësore me relatores kërkuesen në fjalë dhe çështja ndodhej akoma në fazën e diskutimeve përfundimtare.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në zbatim të parimit të moscenimit të interesit publik nga dhënia e efekte të dorëheqjes përpara afatit ligjor si edhe për të evituar sjelljen e pasojave negative për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhënien e drejtësisë, nuk procedoi me dërgimin e trajtimit të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 65 të ligjit 96/2016.

Neni 64 i ligjit të sipërcituar “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ka përcaktuar si mbarim të statusit edhe rastin e dorëheqjes.

Ky institut është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë. Ai bazohet në vullnetin e lirë të magjistratit për të ndërprerë në çdo kohë vijimin e detyrës dhe për rrjedhim kontrata e shërbimit për këtë shkak përfundon. Magjistrati me shkresë të depozituar në Zyrën e Protokollit ka shprehur dëshirën e saj për t’u dorëhequr duke qartësuar dhe siguruar vullnetin përpara institucionit si edhe ka kërkuar deklarinimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes.

Për këtë shkak, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e saj si gjyqtare nga Gjykata e Apelit Shkodër, duke përgatitur edhe projektvendimin përkatës, në dispozitivin e të cilit do të gjeni: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj.{...} , gjyqtare e Gjykatës së Apelit Shkodër, në datë 31.12.2019, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtares.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj.{...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votim, nëse s’kemi diskutime mbi projekt-aktin?

Po!

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, thjesht referuar datës së kërkesës, më lindi ky arsyetim. Sepse në referim të datës 22.11, atëherë ne jemi në kushtet në fakt të paragrafit të dytë të nenit 65, pra thjesht ajo ka kaluar afatin të cilin kërkon ligji, në fund të muajit pasardhës, brenda dy javësh, Këshilli mblidhet, kështu që unë e quaj jo koherente këtë pjesën tjetër të arsytimit në lidhje me kërkesën për dhënien e dorëheqjes përpara afatit, sa jemi në këtë kohë që jemi, prandaj dhe s’do desha t’i hyj fare referimit në ato fakte, për sa ne...

Por, për të shtuar mund të them faktin që, do duhet që kërkesa e saj, për efektin e kësaj magjistrateje, për efektin e kërimit të dorëheqjes me efekte të përsheptuara, të na ishte paraqitur ne si Këshill përpara dhe të mund të kishim gjykuar për situatën në fjalë, që të çmonim edhe motivimin e kërkesës, edhe rastin e justifikuar, debat për të cilin të paktën unë e kam, dhe pastaj të shpreheshim sepse ligji e lidh me miratim nga ana e Këshillit.

Kështu që, në aspektin e dorëheqjes unë jam dakord dhe do ta votoj pro sepse jemi në kushtet e paragrafit të dytë, por ne nuk mund t'i hyjmë më debatit për pjesën e asaj, për sa ka ikur koha dhe s'jemi koherent. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, nëse do të krijojmë standard edhe në të ardhmen që çdo motiv që do paraqitet duhet t'i nënshtrohet vendimit të Këshillit, okej, jam plotësisht dakord që të gjithë motivet që magistratët paraqesin për të dhënë dorëheqjen dhe për të justifikuar pikën 3 të nenit 65, okej, hajde ta kthejmë në standard.

Në rastin konkret nuk u pa e arsyeshme të procedohej në këtë aspekt sepse zonja në fjalë kishte bërë 73 seanca në apel dhe akoma ishte në pretendimet e fundit dhe sot e kësaj dite akoma nuk është shpallur.

Pra një zvarritje tej afateve, për më tepër në gjykatën e apelit që është e pajustificuar nuk mund të na lejonte të procedonim me marrjen përsipër të shkakut shëndetësor sepse në çdo moment, duke marrë parasysh diagnozën që ka paraqitur, personi mund të paraqitet në punë dhe të përfundojë atë detyrë që ka nisur dhe mos të sorollati njerëzit nëpër gjykime.

Kështu që në këtë aspekt, u mendua që të mos procedojë me miratimin e këtij shkakut që kjo ka kërkuar për të justifikuar dorëheqjen e përshpejtuar. Kështu që, hajde ta kthejmë në standard që, çdo motiv që na vjen nga magistratura në të ardhmen, paraprakisht ta sjellim në Këshill, për të biseduar pastaj nëse do ta pranojmë apo jo.

Maksim Qoku: Zoti Toro, ne jemi tek e njëjta gjë. Problemi është, nuk kemi pse vëmë standard, se e ka vënë ligji. Edhe kërkesën për dorëheqje do e miratojmë ne, por nëse është brenda afatit deklarativ, por edhe kërkesën me afat të përshpejtuar, do e bëjmë ne (Këshilli). Ka mbaruar kjo punë. Nuk e ka Komisioni i Karrierës.

Unë e kam fjalën. Ja të bëj dy pyetje. Më lejoni!

A e ka vazhduar punën kjo gjyqtare gjatë kohës që ka kërkuar dorëheqjen, apo është me raport?

Dhe pyetja e dytë, -aktualisht e ka dhënë vendimin për të cilën ne menduam që është e rëndësishme që mos t'ia njohim me efekt të përshpejtuar dorëheqjen, sepse duhet, sepse ishte në diskutime përfundimtare?

Keni dijeni për këto dy fakte?

Alban Toro: Atëherë, përpara se të ishte përgatitur ky, kam kërkuar informacion, pra përpara se të depozitoja në sekretari këtë relacion, kam kërkuar informacion nga kancelaria e gjykatës, konfirmim që s'më ka ardhur akoma.

Në biseda informale më është konfirmuar që zonja në fjalë paraqiste vazhdimisht raporte, kthehej në punë, paraqiste raporte dhe çështja në fjalë nuk ka mbaruar.

Maksim Qoku: Okej, faleminderit!

Pra për ta mbyllur. Ku e kisha unë idenë.

Në respektim të nenit 65, unë jam te pjesa e anëtarëve të Këshillit që shpeshherë dal kundër sepse them, që është krijuar një rregull nga ana e ligjvënësit për efektin e një rasti përjashtimor në paragrafin e tretë dhe ne jemi deklarativ si Këshill, për sa i përket plotësimit të afatit për mbarimin e statusit, por jemi miratues të kërkesës së tij në rastet e shkaqeve të justifikuara, për kërkesa të motivuara.

Mua logjika jote në relacion më vjen për shtat për të gjithë qëndrimet kundër sepse kam pretenduar që nuk është kërkesa e motivuar e magjistratit ajo që duhet domosdoshmërisht të na çojë ne në vendimmarrje miratimi. Duhet të shohim raportin që krijohet midis shkakut objektiv-subjektiv, midis interesit të lartë publik që prevalon mbi gjithçka dhe angazhimit të magjistratit në të ardhmen. Bile-bile shtoj edhe pyetjen e tretë, -a mos kjo po legjitimon në tendencë një shmangie nga procesi i vetingut, duke dashur që të kërkojnë dorëheqjen?

Atëherë mua, zakonisht, e kam ngritur si problem, e kam depozituar edhe në vendimet e tjera, por a është verifikuar ndonjëherë nga Komisioni i Karrierës në letërkëmbime me institucionin e KPK-së që cila është situata aktuale gjatë kohës që magjistratët kërkojnë? A kemi të drejtë ne ta kërkojmë? –Kemi!

Se ç'përgjigje na ka ardhur.

A është bërë nga ana jonë kjo gjë?

Ç'rëndësi ka?! Nuk ka rëndësi.

Naureda Llagami: Zoti Toska!

Ilir Toska: Po bëjmë diskutim pa vlerë.

E gjithë kjo që thotë zoti Qoku ne e konsiderojmë në çdo rast.

Nëse ata largohen për shkak vetingu apo për një arsye tjetër, nuk është një çështje që ne duhet të fillojmë të diskutojmë për këtë rast apo për të gjitha rastet.

Nëse largohen nga sistemi, është një çështje e vullnetit të tyre.

Nëse s'duan t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, është një çështje e vullnetit të tyre.

Ligji ka parashikuar pasoja.

Ne s'mund të pengojmë askënd apo të mbajmë me zor në sistem, prit sa të mbarojë procesi i rivlerësimit, këtë javë apo pas 1 viti.

Ne duhet të shqyrtojmë kërkesat që na paraqesin magjistratët, sipas ligjit dhe konsiderojmë në çdo rast nëse cenohet interesi publik. Faleminderit!

Maksim Qoku: Zoti Toska! Nuk e kisha fjalën për të bërë këtë gjë. Se këtë e di unë. Unë e kisha fjalën që ne kemi detyrimin e paragrafit të tretë që të çmojmë shkakun e motivuar dhe shkakun i motivuar ka të bëjë midis analizës që ne i bëjmë interesit të lartë publik dhe kërkesave të tjera, të cilat shpeshherë mund ose jo të jenë të justifikuara.

Ka për shembull diagnoza të cilat janë mjekësore dhe rrezikojnë jetën, dhe natyrisht që ajo bëhet prevalue. Ka që bëjnë pamundësinë e kryerjes së profesionit sepse mund mendërisht të goditet, edhe kjo është prevalue për ... të interesit. Por ama çdoherë ne bëjmë analizën e prevalencës midis njërit dhe tjetrit. Këtë po them unë. Jo, kush do ta kërkojë, kur do ta kërkojë dhe a do ta kërkojë. Ajo është punë e tyre. E kam për analizën mbi shkaqet.

Naureda Llagami: Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Brikena Ukperaj: Unë doja të shtoja diçka.

Sigurisht që gjyqtari mund të japë dorëheqjen, madje nuk ka nevojë as për të na pasqyruar arsyet e dorëheqjes, në çdo moment dhe ky është parim i përgjithshëm i vendosur në ligj, dhe normalisht efektet i mbarojnë në muajin pasardhës.

Ajo që shtrohet në diskutim në këtë rast është fakti që Këshilli nuk ka patur mundësi dhe nuk ka aktualisht mundësi të shprehet për efektet e menjëhershme të dorëheqjes sepse kanë kaluar afatet dhe ideja është që Komisioni është kthyer në vendimmarrës në këtë rast sepse duke e lënë që të kalojë muaji pasardhës në fakt e ka konsideruar që kjo nuk është dorëheqje e menjëhershme dhe ky është ai standardi që ne

duhet të vendosim, që të gjitha dorëheqjet që paraqiten, duke qenë që për çështjen e dorëheqjes është kompetencë e mbledhjes plenare, pavarësisht, arsyetimet duhet të vijnë në Këshill në qoftë se gjyqtari e kërkon atë në mënyrë të menjëhershme dhe Këshilli mund të shprehet është i menjëhershëm apo jo dhe nëse vlerëson që nuk është i menjëhershëm, mund t'ia mbaroj që në atë moment statusin pas një muaji. Sepse afati “jo më vonë se dy javë pas” është afat maksimal. Nuk do të thotë... Mund të shprehet edhe më përpara Këshilli. Nuk e ka të ndaluar.

Pra, mendimi im është që në qoftë se dorëheqjet vijnë nga gjyqtarët me argumentim që “duan mënyrë të menjëhershme”, duhet t'i përcillen për vendimmarrje mbledhjes plenare. Se po ta lëmë të kalojë afati, mbledhja nuk do ketë më mundësi dhe interes që ta konsiderojë atë të menjëhershme sepse normalisht ajo është trajtuar si dorëheqje normale. Kjo ishte.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në vendimmarrje të projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj.{...} , gjyqtare e Gjykatës së Apelit Shkodër, më datë 31.12.2019, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtares.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj.{...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së

sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.01.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...} për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:06 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
11. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
12. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
13. *Erion Fejzulla, USAID.*
14. *Valbona Bala, USAID.*
15. *Aida Mako, EURALIUS.*
16. *Anisa Kuqi, EURALIUS.*
17. *Arlind Maloku, QE.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarit {...} për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës., e cila edhe kjo ka të bëjë me deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për gjyqtarin {...} për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit. Relatimi i këtij projekt-akti do bëhet nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit, Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 23.12.2019, është depozituar kërkesa nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, z. {...} , nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit për arsye shëndetësore.

Bashkangjitur kërkesës ai ka depozituar edhe dokumentacionin përkatës shëndetësor.

Ndërkohë kur dorëheqja sipas nenit 65 të ligjit të Statusit jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes, domethënë më datë 31.01.2020, zoti {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës së përcaktuar nga ligji.

Nga sa më sipër, rezulton që në rastin konkret të plotësohen kërkesat e ligjit për miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të dorëheqjes së gjyqtarit z. {...} , duke i dhënë asaj efekte përpara kohës së përcaktuar nga ligji, pika 2, e nenit 65, të ligjit të Statusit.

Së pari, pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga statusi i magjistratit; Kjo kërkesë është e motivuar dhe; Së treti dhënia e efekteve të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtarit z. {...} duhet të japë efektet, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtarit nga njëra anë, por edhe lënien e një kohe të mjaftueshme për dorëzimin e detyrës nga ana e tij.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është data 15.01.2020, pra propozon që efektet e dorëheqjes të fillojnë në datën 15.01.2020, sigurisht, nëse Këshilli nuk ka një mendim ndryshe.

Sa më sipër, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...} , gjyqtar i Gjykatës së Apelit Korçë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status.

Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 15.01.2020.

Të përjashtojë gjyqtarin z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Korçë.

Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë, nëse s'kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatorja?

Maksim Qoku: Kundër. Për të njëjtat shkaqe që kam arsyetuar edhe më parë.

Marçela Shehu: Jo! Një sekondë. Se kam përshtypjen nuk është e njëjta situatë. Për zonjën Rraboshta ju thatë që kërkesa...

Ehë, thash se e lidhët me zonjën {...}. Se kam përshtypjen që situatat faktike janë ndryshe.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

(Vota e zonjës Luli nuk dëgjohet.)

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...} , gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 15.01.2020.

Përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Korçë.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të

drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Punë të mbarë.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor